



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.shk.II.nr.56/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbare të kreditorit NP Ihk “I...” sh.a, rr. “I...”, Fushë Kosovë, kundër debitorit K.S S... – Dega D..., përfaqësuar nga Sh.H. , rr. “...”, Mitrovicë, e të cilin me autorizim e përfaqëson Kadri Osaj, avokat në Mitrovicë, me bazë juridike përmbare për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.640/2019, të datës 04.10.2019, me datë **23.08.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit NP Ihk “I...” sh.a, rr. “I...”, Fushë Kosovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.640/2019, të datës 04.10.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.640/2019, të datës 04.10.2019, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit K.S S... – Dega D..., përfaqësuar nga Sh.H. rr. p/n Mitrovicë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbaremit P.nr.110/2019 të dt.30.05.2019, si dhe ka shfuqizuar urdhrin mbi lejimin e përmbaremit P.nr.110/2019 të dt.30.05.2019, dhe ka abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani në këtë çështje përmbare.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbare, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që të ndryshojë aktvendimin e atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbare P.nr.110/2019 i datës 30.05.2019.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala debitor.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori NP Ihk "I..." sh.a, rr. "I...", Fushë Kosovë, me datë 29.05.2019, ka paraqitur propozim për përmbarrim, kundër debitorit K.S S... – Dega D..., rr. "...", Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit të verifikuar nr.KLT-1530 e regjistruar me datë 16.15.2019, bazë e së cilës është Kontrata mbi dhënien e pronës së Hekurudhës me qira, nr.06/0515 e datës 28.07.2006 dhe aneks kontrata nr.06/215-2 e datës 12.01.2007, për pagesën e borxhit në emër të qirasë në shumë prej 553.84 euro.

Përmbarruesi privat Emine Sherifi-Lubeniqi, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin P.nr.110/2019 të datës 30.05.2019, ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 17.06.2019, ka ushtruar prapësim duke theksuar se borxhi i pretenduar është parashkruar, andaj i propozon gjykatës së shkallës së parë të aprovoi prapësimin dhe të anuloi urdhrin përmbarrimor dhe veprimet e kryera, të obligohet kreditori që t'i paguaj shpenzimet e procedurës përmbarrimore, për përpilimin e prapësimi sipas tarifës Odes së Avokatëve 156€, për përfaqësim 117€ si dhe shpenzimet tjera.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke theksuar se kreditori ka shfrytëzuar të drejtën e tij në përputhje me dispozitat e LPP-së për inicimin e procedurës përmbarrimore, ndërsa prapësimi i debitorit është i paqëndrueshëm, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar PPP.nr.640/2019, të datës 04.10.2019, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbarrimit P.nr.110/2019 të dt.30.05.2019, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarrim të dokumentit të besueshëm- ekstraktit nga librat afarist, mbi bazë të së cilës përmbarruesi privat e ka lejuar përmbarrimin. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj ka sqaruar se i ka refuzuar ne tërësi si te pabazuara pretendimet e debitorit se ne rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 29 par.1.2 të LPP-së, për faktin se dokumenti përmbarrues (ekstrakti nga librat afarist) nuk është i përshtatshëm për përmbarrim, është i mangët, nuk është i mbështetur ne fatura, e po ashtu gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjen nuk ka pranuar as kundërshtimet e debitorit me pretendimin se raporti juridik është themeluar ne mes te KS S... dhe kreditorit, e ku mbi këtë baze kreditori nuk ka legjitimet, për faktin se i njëjti është nënshkruar i kontratës se qirasë ne emër te KS S....

Ne arsyetim te aktvendimit te atakuar gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar dhe ka pranuar si te bazuar kundërshtimin e debitorit se borxhi i kërkuar është ne tërësi i parashkruar, ne kuptim te nenit 375 te LMD –se vitit 1978, ku është përcaktuar se "Kërkesat e qirasë si ato qe janë caktuar

te paguhen periodikisht ashtu edhe ato qe janë caktuar te paguhen ne mënyrë paushalle parashkruhen për tri vjet”, derisa ne rastin konkret kreditori ne propozim për përmburim kërkon përmburjen e detyrimit – pagesën e borxhit ne emër te qirasë për periudhën kohore 05.09.2006 – 01.02.2007, kurse propozimin për përmburim e ka ushtruar me dt.29.05.2019, nga ku rezulton se nga koha kur është bere pagesa e arritshme për pagese, e deri ne momentin e ngritjes se propozimit për përmburim kane kaluar me shume se 11vjet, andaj kërkesa e kreditorit është parashkruar ne tërësi.

Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmburimor.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim te kërkesës ne kuptim te nenit 375 te LMD –se vitit 1978, ku është përcaktuar se “Kërkesat e qirasë si ato qe janë caktuar te paguhen periodikisht ashtu edhe ato qe janë caktuar te paguhen ne mënyrë paushalle parashkruhen për tri vjet”, derisa ne rastin konkret kreditori ne propozim për përmburim kërkon përmburjen e detyrimit – pagesën e borxhit ne emër te qirasë për periudhën kohore 05.09.2006 – 01.02.2007, kurse propozimin për përmburim e ka ushtruar me dt.29.05.2019, nga ku rezulton se nga koha kur është bere pagesa e arritshme për pagese, e deri ne momentin e ngritjes se propozimit për përmburim kane kaluar me shume se 11vjet, andaj kërkesa e kreditorit është parashkruar ne tërësi dhe si e tillë nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përmburimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se është ndërprerë parashkrimi për shkak te padisë se ushtruar, pasi qe siç rezulton nga shkresat e lendes (e njëkohësisht e pohon edhe vet kreditori) padia është tërhequr me vullnetin e palës paditëse (këtu kreditorit) drejtuar gjykatës, me arsyetimin se ceshtjen kontestuese do te e zgjidhin ne mënyrë tjetër.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.56/2022, me datë 23.08.2022

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v.